



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr. 7766

Data: 13.09.2023

**PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR NË GORANCË PËR DRAFT BUXHETIN
PËR VITIN 2024 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2025-2026**

Procesverbali nga Dëgjimi i pestë Buxhetor në lidhje me Draft Buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2024 dhe parashikimi për vitet 2025-2026, të mbajtur me datën **16.08.2023**, duke filluar nga ora **13:00** në ShFMU “Veli Ballazhi” në Gorancë, me gjithsej 38 pjesëmarrës, prej tyre 4 gra dhe 34 burra. Nga ekzekutivi, të pranishëm ishin Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, **z.Mehmet Ballazhi**, si dhe disa nga drejtorët e drejtorive.

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës **z. Mehmet Ballazhi**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve që kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin buxhetor për prezentimin e draft buxhetit të Komunës Hanit të Elezit për vitin 2024, si dhe parashikimi për vitet 2025-2026, ku për rend të punës, ishte:

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2024 dhe parashikimi për vitet 2025-2026**
2. **Diskutimi**

Mehmet Ballazhi thekson: Jemi në fazën e dëgjimeve buxhetore dhe sot jemi në Gorancë, ku para jush do të bëjmë prezentimin e projeksioneve buxhetore, por jemi këtu që të marrim edhe idetë dhe propozimet tuaja sipas kërkesave dhe nevojave që ju i shihni si të arsyeshme për Hanin e Elezit, konkretisht për fshatin Gorancë. Prezentimin e këtij draft buxheti do ta bëjë Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Lindita Ballazhi, ndërsa prezent janë edhe disa nga drejtoritë që mund të ju drejtoheni për çështje të caktuara.

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2024 dhe parashikimi për vitet 2025-2026**

(Drejtoresha Lindita Ballazhi përshëndet dhe falënderon të pranishmit për pjesëmarrje në dëgjim buxhetor)

Lindita Ballazhi thekson: Buxheti paraqet një instrument mjaft të rëndësishëm financiar në të cilin specifikohen të hyrat dhe shpenzimet për një periudhë të caktuar kohore një vjeçare, duke filluar nga 1 janar deri në 31 dhjetor. Planifikimi i Buxhetit Komunal kalon nëpër disa faza, duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Planifikimi buxhetor fillon me lëshimin e Qarkores së parë Buxhetore nga Ministria e Financave deri me 15 maj. Faza e dytë është hartimi i KAB-it në bazë të Qarkores Buxhetore ku kemi kufijtë fillestarë buxhetor. Për hartimin e KAB-it ne kemi mbajtur diskutime me asamblesë

komunale, dëgjime buxhetore me qytetarët, si dhe është bërë miratimi i KAB-it në Kuvend Komunal më 30 qershor. Faza vijuese është pranimi i Qarkores së dytë Buxhetore nga ana e Ministrisë së Financave, e cila lëshohet më 15 gusht dhe më pas kemi bërë përgatitjen e draft buxhetit, si dhe vijon mbajtja e dëgjimeve publike. Faza përfundimtare e planifikimit buxhetor është miratimi i draft buxhetit në Kuvend Komunal, dhe veprimi i fundit është dorëzimi i draft buxhetit në Ministri të Financave deri më së voni 30 shtator. Buxheti i komunës përfshin këto struktura të financimit, ku për vitin 2024 do të jenë: granti i përgjithshëm (1,583,941.00 €), granti specifik për arsim (1,089,623.00€), granti specifik për shëndetësi (401,388.00€) dhe të hyrat vetanake komunale (274.736.00 €). Pra, buxheti total për vitin 2024 do të jetë 3,349,278.00 €. Në vazhdim, kemi bërë planin e ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale për vitin 2024, siç e shihni në projektor, këtu kemi të përfshime drejtoritë komunale, shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, si dhe arsim dhe shkencë. Ndarja e buxhetit është bërë në bazë të kufijve buxhetor, për çdo kategori buxhetore: paga dhe shtesa, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere, si dhe shpenzime kapitale. Nëse e krahasojmë me vitin e kaluar, kemi një rritje të dukshme në të gjitha kategoritë buxhetore, përveç tek të hyrat vetanake komunale ku do të ketë rënie prej 51%. Mandej vijojnë të gjitha projektet kapitale të cilat i keni para vetes tuaj në letër, të cilat janë planifikuar nga drejtoritë dhe ekzekutivi, si dhe disa janë marrë edhe nga dëgjimet paraprake që kemi pasur në qershor. Nëse keni ju ndonjë projekt propozim apo kërkesë, mundeni ta parashtroni.

2. Diskutimi

Mehmet Ballazhi: Pas prezantimit nga drejtoresha, unë e hap diskutimin për të pranishmit.

Shefket Lusnjani: Fillimisht sa për njoftim të shkurtë para banorëve, fshati Gorancë është ndihmu rreth 100 mijë € nga buxheti i Komunës Hani i Elezit, gjithashtu falënderoj Majlindën drejtoresha tuaj që ka kontribu duke na e bo planin e odës së pritjes falas. Por kemi edhe disa kërkesa tjera:

- rruga Bypass që ka rëndësi për banorët sepse rruga aktuale ka rrezik për ne;
- rruga Krevenik-Gorancë e cila kushton mbi 1 milion €, por kisha propozu që me u kry pjesë pjesë sipas mundësive;
- çështja e ujësjellësit është kry falë Komunës , por edhe banorëve;
- edhe vitet e kalume kemi bo kërkesë për me u shtru me kubëza rruga për te varrezat në Rezhancë;
- kërkesa ka qenë edhe e mëhershme që me u vendos rrethojat te varrezat e Hunelëve, diku i ka 200 metra.

Selman Vila: Tek draft buxheti po e shoh se grandit specifik i arsimit kriter kryesor për rritjen ka numrin e nxënësve , do me thanë sipas kësaj a ak rritje të numrit të nxënësve në Han të Elezit apo cila është arsye dhe ky grant për 2024 ka rritje, e njëjta edhe te grandit i shëndetësisë, nëse ka mundësi arsyen pse.

Lindita Ballazhi: Granti specifik i arsimit ka kriter kryesor numrin e nxënësve por jo si kriter të vetëm, ku për vitin e ardhshëm kjo ngritje e këtij granti ka ndodhur si pasojë e hyrjes në fuqi të Ligjit të ri të pagave, ku janë rritur pagat , dhe në vitin aktual granti është diku 96 mijë € është

më i ulët se vitin e ardhshëm dhe pagat paguhen nga grandit specifik i arsimit. I njëjti arsytim është edhe për grantin specifik të shëndetësisë.

Hazbi Berisha: Në Gorancë shpesh organizohen nga banorët aksione të pastrimit, dhe deshta me ditë a ka ndonjë projekt apo marrëveshje për mirëmbajtje të rrugëve, duke e përfshirë edhe Gorancën? Poashtu, në draft buxhet pash një pikë për shenjëzime pikave turistike në Han të Elezit, pak ma shumë informacion?

Mehmet Ballazhi: Janë për me u falënderu të gjitha aksionet vullnetare nga banorët për pastrim, ne si Komunë kemi marrë veshje me Kompaninë "Pastrimi", ku ata bëjnë mirëmbajtje të rrugëve të disa rrugëve, therrave poashtu të mbeturinave, biles edhe për vendet ku nuk jemi në përgjegjësi për pastrimin e tyre shembull rrugët që ka obligim Ministria e Infrastrukturës, ka ndodh që ne si Komunë, kemi angazhu kompaninë me e bo pastrimin e rrugës deri në Gllloboçicë, dhe kompania sa herë ka pas kërkesa nga banorët, ka pranë. Mjafton ta bëni kërkesë zyrtare sa herë ka nevojë, dhe sipas planifikimeve të kompanisë, ata angazhohen.

Majlinda Kaloshi: Ne kemi mendu që me kriju harta turistike me i paraqit pikat turistike që ka Hani i Elezit, ku janë me informacionet përkatëse për secilën pikë, gjithashtu do të ketë edhe zyrë të veçantë në kuadër të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm të dedikuar për turizëm.

Naser Kaloshi: Te rruga e Shemta, dihet se sa rrezik u bo aty me kalu, edhe pse nuk është në kompetencën tuaj, a dihet çfarë masash janë marrë a kur do të rregullohet, apo duhet me vazhdu me protesta.

Mehmet Ballazhi: Në protestën e fundit që osht organizu nga banorët, unë edhe si banor por edhe si Kryetar, kam qenë pjesëmarrës për me ju tregu që unë jam krah juve në shqetësimin tuaj. Ne vazhdimisht kemi kërku nga Ministria për zgjidhje, kemi dërgu shkresa e kërkesa të shumta, madje kam zhvillu takim edhe me zv.Ministrin Durmishi dhe sipas tij, data 30 qershor ka qenë dita e fundit kur kompanisë u dashtë me ia marr të drejtën e punimeve dhe deri tani nuk kemi më asnjë informacion.

Nusret Berisha: Qysh u përmend ma herët, ne si fshati organizojmë shpesh aksione të pastrimit, e nëse do të ishte mundësia që kompania me e bo pastrimin e therrave shkak se i kanë mjetet ma adekuate? Poashtu a ka ndonjë datë se kur mund të futet ByPass në projekte? Si dhe kisha propozu që me u hap një rrugë nga Goranca për me dal te Varrezat e Dëshmorëve në Pusteni pak ma shkurt mos t'shkojmë deri atje poshtë?

Selman Vila: Për me u lidh te pytja e Nusretit, unë menoj që rruga e ByPass duhet me u zhvillu ne disa faqa, e para është me pa se rruga që mendojmë ajo kalon nëpër prona private, dhe duhen me u përcaktu pikat se kah kalon rruga, kurse ma vonëse me fillu spaku me e hap si trasë.

Mehmet Ballazhi: Për krasitje apo largimin e therrave, e thash edhe ma herët, bëni kërkesa dhe më pas kompania e vlerëson sipas planifikimeve që ia kanë për zonat që i kanë në Të gjitha rrugët që u propozuan për me u rregullu janë më se të nevojshme dhe për me planifiku janë shumë të kushtueshme dhe e kemi të vështirë me i fut si projekte e mos me pas buxhet, ne i

planifikojmë së paku në hartim të projektit, siç kemi projektin e rrugës Gorancë-Krevenik, mbikalimet te hekurudha apo projekti i ashensorit te komuna dhe presim vetëm që të has në pranim në Qeveri. Te Rruga Bypass ne nuk kemi projekt të gatshëm, vitin e kaluar ne kemi kërku nga FSK së paku me na e hap si rrugë dhe ne me vazhdu me e shtru me zall apo zhavor apo asfalt, por fillimisht duhet angazhim edhe nga administratori që të mund të dihen nëpër cilat prona kalon, ku duhet mas pari me u caktu vija kah kalon, dhe ju mundeni me bo kërkesë për me e hartu projektin dhe ne vazhdojmë me projektin ideor apo detal të rrugës.

Lindita Ballazhi: Ne i kemi shënuar të gjitha kërkesat e juaja dhe të gjitha do të shqyrtohen dhe do të japim maksimumin që së paku disa të ua realizojmë. Çfarëdo kërkesë që keni, jo vetëm nëpër dëgjime, por çdo herë dyert tona janë të hapura në çdo kohë.

Mehmet Ballazhi: A ka edhe dikush diçka me shtu apo me plotësu? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur dëgjimin buxhetor në fshatin Gorancë.

Mbledhja përfundoi në ora 14:25.

Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi



Kryetari Komunës
Mehmet Ballazhi



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit








Lista e pjesëmarrësve – Takimi i pestë me qytetarë lidhur me planifikimin e
buxhetit për vitin 2024 - Gorancë

Data: 16.08.2023

Ora: 13:00

Vendi: SHFMU "Veli Ballazhi" - Gorancë

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita/Institucioni/Vendi	Telefoni	Nënshkrimi
1	MALIK BERISHA	KESHILLTAR KOMUNAL	049928793	
2	SELMAN VIZA	qytetar	079757345	
3	ENSAR BERISHA	KATUNAR		
4	Alusret Kaloshi			
5	Thurzbi-Berish			
6	Rashid Lusnjani	Akator i fjalorit	044227369	
7	Enis Berisha			
8	FADUL BERISHA	PUNTORE		
9	ZIRAP BERISHA			
10	EKREM LUSNJANI	PENSIONER		
11	NASEK KALOSHI			
12	SEKRET BERISHA			
13	XHEVDET BERISHA			
14	MALIQ BERISHA			
15	NESHAT BRAVA			
16	SHUKRI KALOSHI			
17	MEXHIT KRYEZIU			
18	GENAN BERISHA			
19	SEAD BERISHA			
20	HASIP BERISHA			
21	SHEFKET LUSNJANI	ADMINISTRATOR		
22	Nasret Kaloshi	Penzioner		
23	Zirap Berisha			
24	Senad Berisha			
25	Xhevdet Berisha			
26	Malik Berisha			
27	Neshat Brava			
28	Milena Kaloshi			
29	Abdulmeçit Vreça			
30	GENAN BERISHA			
31	SEAD BERISHA			
32	Hasip Berisha			

33	Natyrja Kalisi	DAP	045 813 639	
34	Alsim DERJANI	OSHPF	045-308-843	
35	MAJLINDA KALOSHI	DZNE	049/934-659	
36	Muskerat			
37	LIRIDONA BALLAZHI	Zyra e Kryetarit	044/862-571	
38	Zirideta Ballazhi	Drejtorja DBF	049/922-400	
39	Mehmet Ballazhi	Kryetar	044/225-073	
40				
41				
42				
43				
44				
45				
46				
47				
48				
49				
50				
51				
52				
53				
54				
55				
56				
57				
58				
59				
60				
61				
62				
63				
64				
65				
66				
67				
68				
69				
70				
71				
72				
73				
74				
75				
76				
77				
78				